



Shfaqja Forum Teatër “HISJA”

Rjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) në bashkëpunim me Qendrën për Art dhe Komunitet Artpolis, përkrahur nga PPSE Swisscontact, ka filluar fushatën në kuadër të projektit “Prona e paluajtshme dhe barazia gjinore” përmes prezantimit të shfaqjeve në formë të forum teatrit. Kjo fushatë ka për qëllim të ngrisë vetëdijen tek qytetarët për regjistrimin e pronës së përbashkët dhe ndarjen e trashëgimisë mbi baza të barabarta gjinore.

Shfaqja e parë do të mbahet sot me 11 Korrik në Prizren, duke filluar nga ora 17:00-18:15, në Dokukino, Rr. Marlin Barleti, kompleksi Europa.